



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Nr. 842 Prot.

Tiranë, më 30.4.2024

Njoftim: **LISTA E APLIKIMEVE TË KUALIFIKUARA PËR SKEMËN KOMBËTARE 2024, MASAT 1-7.**

Bazuar në VKM-në nr. 130, datë 6.3.2024 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024” dhe Udhëzimin Nr. 6, datë 7.3.2024 i MBZHR dhe MF “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Kreun VII “Procedura që ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1-7”, përkatësisht pika 3, AZHBR shpall listat e aplikimeve të masave 1 - 7 të pranuar online nga portali e-Albania me të dhëna si më poshtë:

MASA 1: “Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve të gjedhit” janë kualifikuar 3851 aplikime;

MASA 2: “Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve të të imtave” janë kualifikuar 5434 aplikime;

MASA 3: “Për mbarështimin e Bletarisë” janë kualifikuar 4323 aplikime;

MASA 4: “Mbështetje për serat” janë kualifikuar 815 aplikime;

MASA 5: “Mbështetje për Bimë Aromatike dhe Medicinale” janë kualifikuar 953 aplikime;

MASA 6: “Mbështetje për Fermat Organike” janë kualifikuar 169 aplikime;

MASA 7: “Mbështetje për Fermat me certifikimin Global GAP”, janë kualifikuar 48 aplikime.

Të gjitha aplikimet sipas subjekteve/aplikantëve që gjenden në listat e aplikimeve të kualifikuara për masën 1-7 dhe për rastet që kërkohet dokumenti sipas masës përkatëse dhe që kanë nevojë për dokumente shtesë sipas tabelave të mëposhtme, duhet t'i dorëzojnë këto dokumente të plota brenda datës 20.05.2024.

Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë brenda afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Oltjon Muzaka

